



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Data: **18.09.2015**

Për: **“R & T” sh.p.k, Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89, Shkalla A, Kati 10, Tiranë**

Procedura e prokurimit: **Tender i hapur**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ndërtim i qëndrës sportive për sportin Rafting”.**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike, 06.07.2015**

Njoftojmë se kanë qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesit me vlera përkatëse të ofruara:

Nr.	Operatori Ekonomik	Oferta (pa TVSH)
1.	Leon Konstruksion sh.p.k.	34,451,504
2.	R & T sh.p.k.	35,915,060
3.	Everest sh.p.k.	36,215,200
4.	BOE Albavia sh.p.k. & Ed Konstruksion sh.p.k.	39,612,286
5.	4 A-M sh.p.k.	41,345,315

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

Shoqëria “Leon Konstruksion” sh.p.k. për arsye se:

Shoqëria “Leon Konstruksion” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për numrin e nevojshëm të punonjësve. Sipas kërkesës për kualifikim të paraqitur në DST i takon të ketë mesatarisht 100 punonjës në muaj për periudhën Maj 2014 – Maj 2015, ndërkohë që ka paraqitur dokumentacion që vërteton se ka mesatarisht 94 punonjës, duke mos plotësuar kushtin.

Të skualifikojë bashkimin e përkohshëm të shoqërive “Albavia” sh.p.k. (52%) dhe “ED Konstruksion” sh.p.k. (48%) për arsye se:

Shoqëria “Albavia” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për disponimin e pikave të kërkuara të liçencës, pasi nuk e ka paraqitur liçencën e shoqërisë.

Shoqëria “Albavia” sh.p.k, nuk plotëson kërkesën për disponimin e mjeteve, pasi për mjetet “Ekskavatorë me goma” dhe “Fadroma” (mjete që shënohen në rregjistra publike) nuk ka paraqitur dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikatë të kontrollit teknik dhe policë të sigurimit vjetor.

Shoqëria “ED Konstruksion” sh.p.k, nuk plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim, pasi nuk ka paraqitur Ekstraktin e QKR dhe Ekstraktin Historik të QKR.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“R & T” sh.p.k, Rruga “Luigj Gurakuqi”, Pallati 89, Shkalla A, Kati 10, Tiranë, se me ofertën e paraqitur në shumën 35,915,060 Lekë (pa TVSH), është identifikuar si oferta e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, rruga “Sami Frashëri”, nr. 10, Tiranë, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2007 “Për prokurimin publik”.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë: Në datë 27.08.2015

Ankesa:

1. Ankesë nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik “Albavia” sh.p.k. dhe “Ed Konstruksion” sh.p.k, me datë 03.09.2015 dhe ka marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor me datë 07.09.2015.
2. Ankesë nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomik “Albavia” sh.p.k. dhe “Ed Konstruksion” sh.p.k, me datë 04.09.2015 dhe ka marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktor me datë 08.09.2015

